



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:168296

Datë: 30.03.2024

Numri i dokumentit: 05528905

KPPP.nr.1234/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit “Dermals” Sh.P.K., me adresë rruga “Ali Vitia”, lokali 1 dhe 2, llamella 2, nr.1 dhe 2 në Prishtinë, me NUI: 810147935, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson SH.A. avokate nga Prishtina, kundër debitorit “Madam Aesthetics” Sh.P.K., me adresë rruga “Muharrem Fejza” pn, Prishtinë, me NUI: 811496604, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.309/2023 të datës 27.06.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Rushit Hoxha, me seli në Prizren, jashtë seancës me datë 18.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Madam Aesthetics” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.309/2023 të datës 27.06.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Rushit Hoxha, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, me Urdhrin Përbarimor P.nr.309/2023, të datës 27.06.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.23-SHV01-001-3 të datës 23.01.2023, me të cilin ka urdhëruar që në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij urdhri të përmbush detyrimin ndaj kreditorit në shumën prej

61,950.00 Euro, me kamatë ligjore, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përbaruesit Privat, debitori ka ushtruar prapësim, në të cilin ka theksuar se urdhri përbarimor është i bazuar në një dokument të vetëm-faturë në dy faqe, e cila nuk i përmbush kushtet për të qenë dokument i besueshëm, përkatësisht i përshtatshëm për përbarim. Më tej ka shtuar se kjo faturë, është e paguar pjesërisht, për arsye se debitori e ka denoncuar faturën në komunikim me kreditorin, pasi mallrat e liferuara nuk i përmbushin kriteret e përcaktuara në kontratë, dhe si rrjedhojë janë të gatshme për t'u kthyer tek kreditori, dhe të zëvendësohen me mallra sipas porosisë së debitorit. Poashtu ka theksuar se fatura në bazë të të cilës kërkohet përbarimi, është një kopje e pavërtetuar, i ka dy faqe, dhe nënshkrimet janë vënë vetëm në faqen e dytë e që faqja e parë edhe mund të jetë ndërruar. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet si i bazuar dhe të shfuqizohet urdhri përbarimor i Përbaruesit Privat.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit, ngase fatura është dorëzuar në origjinal, dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara për të qenë dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përbarim. Më tej ka shtuar se fatura është regjistruar në librat e shitjes dhe për të njëjtën kreditori ka kryer pagesat e duhura tek organet tatimore të vendit, si dhe e njëjta është e pranuar dhe e nënshkruar nga ana e vet personave përgjegjës të debitorit, gjë që shihet nga vula e debitorit dhe nënshkrimi nga përfaqësuesi i debitorit. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri i Përbaruesit Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, pretendimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet*

dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentin e besueshëm faturën nr.23-SHV01-001-3, të datës 23.01.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.23-SHV01-001-3 e datës 23.01.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njehta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin dhe vulën e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1234/23, me datë 18.03.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.